



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2025/0898**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Vedat Poterqoi dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Seyntex NV kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit të Policia e Kosoves në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me uniforma të rregullta Policore ritender me numër të prokurimit: **214-24-13186-1-1-5**, me 30/10/2025, mori:

### Vendim

1. Përfundon procesi i shqyrtimit administrative filluar sipas ankesës së operatorit ekonomik ankesa e OE Seyntex NV me nr. 2025/0898, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me uniforma të rregullta Policore ritender me numër të prokurimit **214-24-13186-1-1-5**.
2. Ankuesi lidhur me këto veprime të AK rreth anulimit të aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me ligjin, mund të drejtohet Gjykaës kompetente për mbrojtjen e të drejtave të tij/saj.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik.

### Arsyetim

#### *-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Administrata e OSHP-së ka konstatuar se ankesa pas analizimit nga zyra e pranimit në pajtim me nenin 13, 14 si dhe nenit 17 të Rregullores nr. 01/2020, si dhe bazuar në nenin 109 të LPP-së, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marr nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtror ankesë në OSHP, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjedhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Po ashtu, parashtruesi i ankesës e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1.26 i LPP-së, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111 të LPP-së, që do të thotë se i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave ligjore të cituara dhe bie nën kompetencat e këtij organi OSHP. Lidhur me këtë ankesë pas analizimit nga zyra e pranimit në pajtim me nenin 13, 14 si dhe nenit 17 të Rregullores nr. 01/2020, si dhe bazuar në nenin 109 të LPP-së, sipas të cilit kundër çdo vendimi

të marr nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorj ankese në OSHP, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjedhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Po ashtu, parashtruesi i ankesës e ka statusin e palës se interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1.26 i LPP-së, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111 të LPP-së, që do të thotë se i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave ligjore të cituara dhe bie nën kompetencat e këtij organi OSHP, mirpo për Panelin Shqyrtues konsiderohet se ankesa e parashtruar është në kundërshtim me nenin 10 par 3 i LPP-së.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Seyntex NV janë parashtruar si në vijim:

We, the winning group of Economic Operators of the above-mentioned procurement activity, hereby submit this complaint in accordance with Article 108/A of Laë No. 04/L042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, as amended and supplemented by Laë No. 04/L-237, Laë No. 05/L-068, and Laë No. 05/L-092. Factual Background On 07.02.2025, the Contracting Authority (Kosovo Police) issued a Notice of Award in our favor for the procurement activity Supply of Regular Police Uniforms - Ritender .214- 24-13186-1-1-5. The complaint period expired without any challenges, making the award final and binding in accordance with Article 61 LPP. In line with the award decision, we submitted repeated requests on June and July for the signing of the contract, in accordance with the Laë on Public Procurement. Despite the legal obligation, the Contracting Authority did not proceed with contract signing for more than six (6) months after the award notice. On 21.08.2025, the Contracting Authority issued a Notice of Cancellation, citing Article 26(2) of the LPP regarding the requirement for signatures of large-value contracts. Grounds of Complaint Unlawful Cancellation – Violation of Article 61 and 62 LPP Article 61 LPP obliges the CA to finalize the contract with the successful Economic Operator once the award is final. Article 62 LPP allows cancellation of a procurement activity only before the award or in narrowly defined circumstances. After the award and expiry of the complaint deadline, cancellation is unlawful. By cancelling six months after the award, the CA acted in direct violation of Articles 61 and 62 LPP. 3.2 Misapplication of Article 26 LPP Article 26(2) LPP regulates the signatures required for enforceability of contracts. This article does not authorize cancellation of a procurement activity after award; it simply regulates internal validity of contracts. By using this provision as the basis for cancellation, the CA misapplied the law, thereby committing a procedural violation of Article 26 LPP. Violation of the General Principles – Article 7 LPP Article 7 LPP establishes the guiding principles of procurement: transparency, equal treatment, non-discrimination, proportionality, and legal certainty. By delaying contract signing for six months and then cancelling, the CA undermined: Legal certainty, as the award created legitimate expectations for our company. Transparency and equal treatment, since the cancellation was not based on any lawful ground but on the CA's own administrative failure. Undermining Effective Remedies – Article 108/A LPP The CA's failure to act within the legal timeframe and its late cancellation made it unreasonably difficult for us to exercise effective remedies as foreseen under Article 108/A LPP. Liability for Damages – Article 135 LPP According to Article 135 LPP, the CA is liable for damages caused by unlawful acts in the procurement process. Due to the unlawful cancellation, our company has incurred costs and lost the profit that would have been generated from contract execution. We submitted a request for the review of the cancellation notice in accordance with Article 108/A of the Public Procurement Law, but unfortunately the request was refused by the contracting authority on 02.09.2025. Request Based on the above, we respectfully request that Procurement Review Body: Annul the Notice of

Cancellation; and orders the Contracting Authority to proceed without delay to sign the contract with our company in accordance with the final and binding award decision under Article 61 LPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Administrata e Organit Shqyrtues të Prokurimit me datë 18/09/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0898/2025, ndërsa me datë 28/09/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0898 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK

### ***- Administrimi dhe vlerësimi i provave –***

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Seyntex NV eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2025/0898 ka vlerësuar si në vijim:

#### **I. Rrethanat faktike dhe kronologjia**

1. Me datë 07.02.2025, AK ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës në favor të OE “Seyntex NV”.
2. OE nuk është ftuar për nënshkrim edhe pse ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas nenit 65 të LPP-së.
3. Kontrata është nënshkruar nga Zyrtari Kryesor i Prokurimit dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.
4. Më 11.02.2025, kontrata është dërguar për nënshkrim në Kabinetin e Ministrit të MPB-së, siç është sqaruar nga ZPP në përgjigjen ndaj OSHP-së, ngarkuar përmes platformës E-prokurimi.
5. Me datë 07.08.2025, pas afërsisht gjashtë muajsh, kontrata kthehet e panënshkruar nga Ministri.
6. Më datë 21.08.2025, AK publikon Njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit, duke u thirrur në nenin 26.2 të LPP-së.
7. OE ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim më 26.08.2025, e cila është refuzuar më 02.09.2025 nga AK me të njëjtin arsyetim si në anulim.
8. Si rezultat, OE ka paraqitur ankesën pranë OSHP-së më 12.09.2025.

#### **II. Përmbledhje e pretendimeve të OE ankues**

OE “Seyntex NV” pretendon se:

- Vendimi për anulim është në kundërshtim me nenet 61 dhe 62 të LPP-së, sepse anulimi është bërë pas përfundimit të procesit të dhënies së kontratës dhe pa baza ligjore.
- Neni 26(2) është keqinterpretuar, pasi i referohet procedurës së brendshme të vlefshmërisë, jo një baze për anulim pas dhënies.
- Janë shkelur parimet themelore të LPP-së, përfshirë sigurinë juridike, transparencën dhe trajtimin e barabartë (neni 7).

- Është cenuar e drejta për mjete juridike efektive, për shkak të mungesës së transparencës dhe veprimeve të vonuara nga ana e AK-së.
- AK ka shkaktuar dëme materiale, pasi kompania ka filluar përgatitjet për realizimin e kontratës, duke u bazuar në vendimin për dhënie të saj.

### III. Vlerësimi profesional i ekspertit shqyrtues

Pas shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin e E-prokurimit dhe pas kërkesës të drejtuar në AK për sqarime shtesë, konstatohet si vijon:

1. Raporti i Vlerësimit, i përfunduar më 22.01.2025 dhe aprovuar më 07.02.2025 nga ZPP, përmban deklaratë ku komisioni vlerësues e konsideron ofertën e OE ankues si të papërgjegjshme.
2. Megjithatë, AK më pas publikon Njoftimin për dhënie të kontratës në favor të këtij OE, në kundërshtim të qartë me përfundimin e Komisionit Vlerësues.
3. Kontrata është përgatitur dhe dërguar për nënshkrim në kabinet të MPB, por nuk është nënshkruar nga Ministri, duke cituar mungesën e përmbushjes së kushteve sipas nenit 26.2 të LPP-së.
4. Eksperti ka kërkuar sqarim me shkrim për arsyetimin e Ministrit, por nuk ka marrë përgjigje të detajuar, përveç përshkrimit kronologjik nga ZPP.
5. Bazuar në nenin 26.2 të LPP-së, për kontrata me vlera të mëdha, është kusht i domosdoshëm nënshkrimi nga Ministri, dhe mungesa e këtij nënshkrimi e bën kontratën të pavlefshme.
6. Në këtë rast, refuzimi i Ministrit për të nënshkruar kontratën ka parandaluar zbatimin e një vendimi që bie në kundërshtim me vlerësimin profesional të komisionit, si dhe me vetë LPP-në.
7. Vendimi për anulim i AK-së është i ligjshëm vetëm në aspektin procedural, për shkak të mungesës së nënshkrimit të Ministrit, por mbetet i diskutueshëm në aspektin e zvarritjes së pajustificuar për më shumë se 6 muaj, që cenon efikasitetin dhe parimet e LPP-së.

### IV. Përfundim dhe rekomandim i ekspertit shqyrtues

Bazuar në vlerësimin e mësipërm:

- Ankesa e OE “Seyntex NV” aprovohet pjesërisht si e bazuar, për faktin se është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe janë krijuar pritshmëri legjitime në raport me dhënien e kontratës.
- Vendimi për anulim i Autoritetit Kontraktues mbetet në fuqi, në përputhje me nenin 26.2 dhe nenin 62 par.1. pika1.1 të LPP-së, për shkak të mungesës së nënshkrimit nga Ministri, që është kusht për vlefshmërinë e kontratës në këtë rast.
- Autoriteti Kontraktues duhet të reflektojë mbi vendimin për dhënie të kontratës në kundërshtim me deklaratën përfundimtare të Komisionit Vlerësues, dhe të garantojë përputhshmëri të plotë në të ardhmen midis vlerësimeve profesionale dhe vendimeve ekzekutive.
- Po ashtu, AK duhet të përmirësojë menaxhimin kohor dhe koordinimin ndërinstytucional, në mënyrë që të shmangen vonesat të tilla dhe të ruhet integriteti i procesit të prokurimit publik.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa as OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

### ***-Konstatimet e Panelit Shqyrtues-***

Paneli Shqyrtues analizoj në tërësi aktivitetin dhe sipas të dhënave në platformën e e-prokurimit fillimisht AK ka publikur B08 Njoftim për dhënie të kontratës me datën: 07.02.2025 , ndërsa më pas ka bërë publikimin e B10 Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 21.08.2025, lidhur me aktivitetin me numër të prokurimit 214-24-13186-1-1-5, për çka AK ka inicuar procedurën sipas nenit 35 , par 2 (iii) Procedur e negocuar pa publikimin e njoftimit për kontratë, dhe tek Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit vëren se në faqën 3 , rubrikën IV.3) ka paraqitur “Arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik: Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit”, dhe V.2) INFORMACIONET SHITESË citohet “ Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, neni 26 Nënshkrimi i kontratave publike paragrafi 2. Përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit të përmendur sipas nenit 26 të LPP-së paragrafin 1. të këtij neni, kontratat me vlera të mëdha të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik. Nga kjo rregull përjashtohet Presidenti, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri. Nënshkrimet e përcaktuara sipas këtij Neni, konfirmojnë dhe pranojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë. Kontratat që nuk nënshkruhen në pajtim me paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni janë të pazbatueshme”

Paneli shqyrtues ka evidentuar dispozitat ligjore për prokurim publik që kanë ndërlidhje me këto veprime të AK Pasi që neni 62 i LPP-së mjaftë qartë precizon se në cilat raste mund të përfundoj aktiviteti i prokurimit,, po ashtu Rregullorja për Prokurim Publik neni 42, përcaktohen rastet se kur mund të bëhet ndërprerja e procedurës së prokurimit, ndërsa, arsyeshmëria e AK për ndërprerje të kësaj procedure, anulimin e këtij aktiviteti nuk parashihet në këtë dispozitë, ngase AK është i obliguar të veproj konform dispozitave ligjore ta bëjë ligjshmërinë e secilit veprim dhe këto të verifikohen para inicimit të aktiviteti të prokurimit por edhe në fazat e më të vonshme, ndërsa, jo në fazën kur publikohet njoftimi për dhënie të kontratës (B08) kur pritet të bëhet edhe nënshkrimi i kontratës nga palët.

Me publikimin e njoftimit mbi dhanje të kontrates ( B08) , sikurse kjo procedur e inicuar nga AK-ja për Panelin Shqyrtues konform dispozitave ligjore konsiderohet aktivitet i mbyllur ashtu siç e përcakton edhe neni 10 paragrafi 3, pika (i) i LPP, citat "*aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit*" si dhe nenin 42.4 të RRPP nr.001/2022. Në nenin 42.4 i RRPP nr. 001/2022, e obligon AK që, citat: "*Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave në Njoftimin mbi Vendimin e AK(B58), Autoriteti Kontraktues obligohet të përgatit draftin e kontratës dhe nënshkruaj ate brenda 30 ditëve kalendarike*", ashtu sikurse e obligon edhe neni 24, paragrafi 2 i LPP "*Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj*".

Andaj, Paneli Shqyrtues bazuar ne nenin 10 të LPP-së , lidhur me nenin 42.4 i RRPP nr. 001/2022, vlerëson se kjo çështje është përfunduar dhe rrjedhimisht vendosi si në pikën 1 të dispozitivit. Kurse ankuesi për realizimi e të drejtës së tij/saj mund ti drejtohet institucioneve kompetente. Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se shqyrtimi i kësaj ankesë bie jashtë autorizimeve të përcaktuara ligjore.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahim**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - Seyntex NV**
- Arkivës së OSHP-së: